



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

N J O F T I M

Për vazhdimin e mbështetjes së fermerëve me serra bujqësore (faza e dytë dhe tretë)

Komuna e Mitrovicës së Jugut, përkatësisht Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural sipas Planit të Punës për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2025, bazuar në Rregulloren Komunale me Nr. Prot.02-060/01-0039654-3/23, dt. 31.05.2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, ka realizuar fazën e parë të mbështetjes së fermerëve me serra në kuadër të projektit “**Subvencionimi i fermerëve me serra bujqësore**”, ku në këtë fazë kanë përfituar gjithsej 52 fermerë, ndërsa faza e dytë dhe e tretë e mbështetjes së fermerëve me serra bujqësore pritet të fillojnë të realizohen në ditët në vijim bazuar në Marrëveshjen për bashkëpunim ndërmjet Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe organizatës Qatar Charity, në kuadër të marrëveshjes së arriturë në komunën e Mitrovicës do të përfitojnë një numër i madh i fermerëve me serra bujqësore, realizimi i këtyre projekteve ka për qëllim fuqizimin e ekonomisë rural dhe gjenerimin e të ardhurave në zonat rural.

Komuna e Mitrovicës së Jugut, përkatësisht Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural do të jetë përherë falënderues për çdo donator dhe mbështetës të projekteve në komunën tonë.

Ferdi KADRIU

Drejtor për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

